



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 07.11.2017 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fikrim Damka, Ilir Deda, Zenun Pajaziti, Adem Hoxha, Ahmet Isufi dhe Milaim Zeka.

Munguan: Fitore Pacolli, Fatmire Kollçaku dhe Glauk Konjufca.

Stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e komisionit, znj. Blerta Deliu- Kodra.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 12.10.2017, 24.10.2017 dhe 30.10.2017;**
- 3. Raportim i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integrimit Evropian, lidhur me përmbushjen e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 12.10.2017, 24.10.2017 dhe 30.10.2017;**

Procesverbalet, nga mbledhjet e datës 12.10.2017, 24.10.2017 dhe 30.10.2017 u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integrimit Evropian, lidhur me përmbushjen e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane

Kryetarja: falënderoi ministren për gatishmërinë e saj për të raportuar para Komisionit për Integritet Evropian dhe shtoi, ftesën për raportim ju kemi dërguar shumë më herët, por për shkak të udhëtimit që kishit në Bruksel ky raportim është shtyrë për sot. Ju kemi ftuar në këtë mbledhje që të na informoni lidhur me, prioritetet e ministrisë të cilën ju e drejtoni, të arriturat dhe sfidat e institucioneve të Kosovës sa i përket përmbushjes së obligimeve nga agjenda evropiane, po ashtu për të na njoftuar për vizitën dhe kërkesat e dala nga takimet të cilat i keni realizuar gjatë vizitë suaj në Bruksel.

Dhurata Hoxha, ministre: tha se sa i përket zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane, kemi progres të mirë në disa aspekte, siç është miratimi i projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit nga ana e Qeverisë, është zbatuar vendimi i agjencisë antikorruption lidhur me emërimin e anëtarëve në bordet e agjencive të pavarura, është bërë publikimi i raporteve financiare të partive politike dhe ka filluar auditimi i tyre. Ndërsa, duhet ende shumë punë në plotësim- ndryshimin e legjislacionit, ndër to është edhe projektligji për suspendimin apo pezullimin e zyrtarëve që dyshohen për korrupsion, plotësim ndryshimi i ligjit për prokurorin me qëllim që të mundësohet rritja e numrit të prokurorëve, të miratohet ligji për arsimin e lartë. Me qëllim të intensifikimit të punës në përmbushjen e veprimeve të ERA-së, tha Këshilli Ministror ka mbajtur takime çdo dy javë. Pritjet tona tha janë që deri në fund të këtij viti eventualisht deri në kuartalin e parë të vitit 2018 të shënohet progres i ndjeshëm në shumicën e veprimeve të parapara në ERA. Sa i përket Raportit për Vendin (ish- Raporti i Progresit), tha tash e tutje ky raport do të publikohet në muajin prill me qëllim që të mbulojë një vit të aktiviteteve të institucioneve dhe të ofrojë një pasqyrë të saktë vjetore. Më 3 nëntor 2017 tha kemi dorëzuar inputin e parë për Raportin për Vendin ku, institucionet tona i janë përgjigjur rreth 1500 pyetjeve të cilat kanë qenë të parashtruara për të gjitha fushat e qeverisjes dhe përafrimit të legjislacionit. Në muajin shkurt tha është afati i dytë kur do të dërgohen të dhënat shtesë për të arriturat eventuale nga muaji nëntor deri në muajin shkurt. Lidhur me strukturat e MSA-së tha me 17 nëntor do të mbahet takimi i dytë i Këshillit të Stabilizim-Asociimit në Bruksel ku do të diskutojnë të arriturat për vitin 2017 dhe do të vendosin prioritetet kyçe për vitin 2018. Institucionet tona tha janë në finalizim të pozicionit shtetëror, i cili pozicion do të prezantohet në Këshill. Nga ky takim tha nuk presim befasi, theksi do të jetë në vazhdimin e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, vazhdimi i dialogut me Serbinë, bashkëpunimi në kuadër të funksionalizimit të Gjykatës speciale, si dhe mirëmbajtja e stabilitet fiskal me theks të veçantë pagesat për veteranët. Sa i përket fondeve të BE-së tha dua të ju falënderoi të gjithë juve, anëtarëve të Komisionit, për miratimin e shpejtë të marrëveshjes së IPA-së 2016. Po ashtu, i njoftoi se kanë finalizuar negociatat për marrëveshjen e dytë IPA 2016 që do të jetë mbështetje direkte buxhetore për reformën e administratës publike. Sa i përket fondeve të BE-së, tha mund t'ju informoi në një takim vetëm lidhur me këtë çështje, sepse këto fonde meritojnë një vëmendje të shtuar nga të gjithë ne duke pasur parasysh shumën e madhe të cilën po e ndan BE për Kosovën.

Kryetarja: tha se ju para pak ditësh kishit një vizitë në Bruksel, ku keni pas rastin të zhvillonit takime më përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe keni pasur mundësinë të

merrni informata lidhur me perspektiven e Kosovës në Bashkimin Evropian. Një rëndësi të veçantë për ne tha ka, po ashtu, edhe procesi i liberalizimit të vizave, ku ndër kriteret e mbetura për plotësim janë edhe luftimi i korrupsionit dhe krimi të organizuar dhe ratifikimi i marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi. Kërkoi të di më shumë lidhur me kërkesat e përfaqësuesve të BE-së për kriteret e mbetura.

Dhurata Hoxha, ministre: tha se gjatë vizitës sime në Bruksel jam takuar me Komisionarin Johannes Hahn ku kërkesa të tij decide kanë qenë: të plotësohet kriteri i mbetur për liberalizimin e vizave, të ratifikohet marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi dhe nëse ka nevojë të rritet presioni i qytetarëve edhe mbi opozitën për mos ratifikimin e kësaj Marrëveshje. Ndërsa Komisionari Hahn ka propozuar që të fillohet implementimi i iniciativës së Komisionit Evropian për “EU Start up facilities” i cili është një projekt që mbështet ndërmarrësit e rinj dhe i njëjti të shtrihet edhe në Kosovë. Ne, menjëherë, kemi shkruar letër dhe kemi përkrahur këtë iniciativë. Nga takimi me Komisionarin Dimitris Avramopoulos tha është kërkuar që Ratifikimi i demarkacionit, është i domosdoshëm. Kosova duhet të tregojë vullnet politik për të shtyrë proceset përpara. Të fuqizohet sundimi i ligjit, të ndryshohet perceptimi se Kosova është vend i korruptuar. Ka rekomanduar që Kosova të shfrytëzojë klimën aktuale pozitive në Parlamentin Evropian dhe të plotësojë kriteret që kërkohen e të marrë liberalizimin e vizave, sepse viti 2019 do të jetë vit i zgjedhjeve në Parlamentin Evropian, që do të thotë më pak fokus në Kosovën. Ndërsa në takimin me David McAllister tha se është thënë që Kosova ka dy detyra kryesore për të përmbushur: ratifikimi i Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi dhe vazhdimi i dialogut me Serbinë i cili duhet të prodhojë rezultate. Po ashtu, duhet të punohet në luftimin e krimi të organizuar dhe korrupsionit. Në të gjitha këto takime tha është bërë shumë e qartë që në momentin që Kosova përmbush kriteret e mbetura do të marrë liberalizimin e vizave. Sa i përket kriterit për luftimin e korrupsionit dhe krimi të organizuar tha mund të them që konsiderohet që ka përparim në krahasim me vitin e kaluar duke pasur parasysh se në track rekord janë 37 raste, nga ato 29 aktvendime.

Ilir Deda: tha se ne duhet t’ju bëjmë të qartë qytetarëve tanë se çështjen e demarkacionit Kuvendi duhet ta përfundojë brenda dy muajve nëse dëshirojmë të marrim liberalizimin e vizave. E kjo çështje tha nënkupton urgjencë, e këtë urgjencë duhet t’ua transmetojmë qytetarëve tanë. Sa i përket Raportit për Vendlin tha, si mund të presim që të kemi një raport të mirë kur ne kemi ende vetëm edhe tre muaj që të përmbushim veprimet nga ERA, e ende jemi shumë larg në përmbushjen e tyre. Sa i përket pakos së ardhshme për IPA tha, është mirë që Komisioni për Integritet Evropian dhe Ministria e Integritetit Evropian të kyçen në hartimin e nevojave të Kosovës, sepse askush më mirë se ne nuk i dinë nevojat tona, por, që fatkeqësisht deri tani këto prioritete janë caktuar nga të tjerët. Duhet të dimë se a kemi nevojë ende për asistencë teknike apo kemi nevojë për fonde për zhvillim. Po ashtu pyeti, nëse ne kemi vetëm edhe dy muaj afat për ratifikimin e marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi, nëse ne duam të kemi liberalizim të vizave, pse kjo çështje nuk po bëhet publike para qytetarëve në mënyrë që të dinë qytetarët se Po demarkacioni i kufirit është kusht për liberalizim të vizave.

Milaim Zeka: tha se te çështja e zbatimit të ligjit nga një hulumtim i përgatitur nga Avokati i Popullit del se legjislatura e kaluar 94% të punës së tyre janë marrë me miratim të ligjeve e vetëm 6% me mbikëqyrje të Qeverisë. Ka pasur rast kur Ministrat nuk i janë përgjigjur ftesë së komisioneve për raportim. Sa i përket zbatimit të ligjshmërisë si një kriter shumë i rëndësishëm, i cili kërkohet të zbatohet nga institucionet tona, ne kemi një

vendim nga Gjykata e Apelit me të cilën tregohet se qytetarët janë vjedhur me vite me pagesën e rrymës që e kanë bërë për pjesën veriore të Kosovës dhe pas saj kemi shefin e rregullatorit të energjisë elektrike që thotë se nuk mund ta zbatojë atë vendim. Pyeti se si reflekton në Bruksel kur një zyrtar i lartë shtetëror del dhe thotë se nuk mund t'i zbatoj vendimet. A mendon se do të kenë ndikim negativ kjo në avancimin e agjendës? Sa i përket çështjes së demarkacionit tha a do të duhej që ju, si ministre të jeni më e prerë, më e drejtpërdrejtë dhe të dilni edhe në mbledhje të Qeverisë e edhe para qytetarëve dhe para Komisionit dhe të thoni se krejt këto deklarata të dala edhe nga Komisioni i ri i z.Bulliçi janë spekulime të pabazuara vetëm për t'i lodhur qytetarët dhe me zvarritur procesin pafundësisht sepse në fund nuk kemi shanse pa e miratuar demarkacionin të fitojmë liberalizimin e vizave.

Ahmet Isufi: Sa i përket kërkesës që të bëhet ratifikimi i demarkacionit e dimë që është kërkesë publike e cila është thënë disa herë. Pyeti në takimet të cilat ju i keni zhvilluar a i keni njoftuar përfaqësuesit e BE-së me punën të cilën e bëjnë institucione tona, se është shkarkuar një komision dhe është emëruar një komision i ri me qëllim të gjetjes së vërtetësisë së demarkimit. Gati të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë kanë pasur probleme me zgjidhjen e kufirit, ka ende që nuk e kanë zgjidhur dhe nuk e kanë pasur kusht për liberalizim. Pra, deri kur Kosova do të jetë sui generis si shtet. Sa i përket presionit qytetar tha, ka pasur presion qytetar, madje ky presion qytetar ka bërë që demarkacioni të jetë shkaktar i rrëzimit të Qeverisë. Për t'u ndryshuar dhe përmirësuar ai demarkacion pikërisht është Qeveria aktuale e cila po punon që të vërtetoi kufirin e saktë të Kosovës me Malin e Zi. Deri më tani qytetarët e Kosovës janë dënuar pa drejtësisht për mos liberalizim të vizave tani duhet që të fokusohemi më shumë në çështjen e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit që është problemi më i madh i Kosovës sesa çdo element tjetër.

Armend Zemaj: Sa i përket konsensusit politik në lidhje me procesin e integritetit po mundohemi që të tejkalojmë dallimet pozitive-opozitive me qëllim të përmbushjes së obligimeve. Sa i përket përmbushjes së MSA-së tha ka shumë pak progres dhe se ky progres është shumë i ngadalshëm. Kërkesat që kanë ardhur nga institucionet e BE-së tha janë shumë të qarta dhe të pandryshueshme, andaj tani vetëm kërkohet implementim ose ne të vazhdojmë t'i neglizhojmë dhe qytetarët tanë të mbesin të izoluar. Ju duhet të shtoni dinamikën e punës dhe të rritni presionin në Qeveri, sepse po e shihni qartë që nga qershori deri më tani ne nuk e kemi asnjë ligj të miratuar nga ana e Kuvendit e që derivon nga kërkesat e agjendës evropiane. Ju, përmendët ligjin për largimin e zyrtarëve të korruptuar! Pyeti, a q shumë zyrtarë të korruptuar keni në Qeveri, sa që duhet të nxirret ligj i veçantë për t'i larguar ata? A nuk keni mundësi që me vendim t'i largoni njerëzit të cilët janë të atakuar për korrupsion?! Bazuar në këto ne jemi duke u kthyer në regres andaj, kërkoi që këto të kthehen në kërkesa imediate dhe të adresohen në Qeveri. Mazhoranca tha mund dhe është dashur që të thërret seanca në mënyrë që këto ligje të miratohen sa më shpejt me qëllim të adresimit të veprimeve që dalin nga Agjenda për Reforma Evropiane. Ligji për KPK dhe arsimin e lartë nga raportet të cilat po i shoh më përkuqtojnë raportin që e kemi pasur standardet para statusit pra, nga ky raport krijohet përshtypja që ne duhet të fillojmë gjithçka nga fillimi. Ne planifikojmë si anëtarë të Komisionit të Stabilizim Asociimit të mbajmë takimin në këtë muaj, por nuk e dimë se çfarë mund të raportojmë si progres. Ne nuk mund të mashtrojmë me retorika BE-në e askënd sepse ata janë këtu dhe po i shohin zhvillimet dhe të arriturat. Andaj, unë ju bëjë thirrje që të shtoni presionin e juaj në institucionet të cilat kanë obligimet në implementimin e këtyre masave. Sa i përket Komisionit për Integritet Evropiane, ne jemi

të gatshëm që të shtyjme përpara veprimet të cilat kërkohen brenda Kuvendit, por nuk kemi produkt nga ana e juaj. Duhet të kemi një agjendë të qartë të bashkëpunimit institucional dhe të shtojmë takimet.

Zenun Pajaziti: Ne jemi më shumë të interesuar që fillimi i këtij mandati të na gjej më shumë të fokusuar në agjendën evropiane, e që ne, si parlamentarë duhet të jemi më shumë të fokusuar në mbikëqyrjen parlamentare. Është gjynah mos me u koncentruar të gjitha kapacitetet tona në adresimin e gjetjes së pengesave në përmbushjen e veprimeve, në identifikimin e sfidave të cilat po ndikojnë në mos avancimin e përmbushjes së këtyre veprimeve. Te procesi i liberalizimit të vizave, si dhe te proceset politike tha duhet të kenë guxim politik qeveria dhe lidhshipi politikë në mënyrë që t' i adresojnë këto veprime shpejt e qartë dhe më i vu pikë në mënyrë që të ecet përpara. Ka prioritete të cilat po barten vit pas viti, nuk mundemi ne si komunitet politikë të bartim barrën për ato që janë bërë ose nuk janë bërë. Mandatin e kaluar tha më shumë është diskutuar për pagat e deputetëve, kurse unë për tri mandate dhe asnjëri nga ne nuk kemi marrë pjesë asnjëherë në vendimet që kanë të bëjnë me pagat tona, ndërkohë që ka pasur tema të cilat është dashur të adresohen për vështirësitë konkrete. Nuk mund të bartin barrën e një zyrtari për mos punën e ti, është koha dhe momenti që këto prioritete të adresohen që ky proces të ecë përpara. Presionin më të madh e kemi për procesin e liberalizimit të vizave.

Dhurata Hoxha, ministre: tha se sa i përket progresit në zbatimin e ERA-së nuk ka progres të kënaqshëm pasi nga 22 veprimet vetëm 1 mund ta konsiderojmë si të përmbushur deri më tani. Ne, si ministri, tha kemi intensifikuar takimet me institucionet më të rëndësishme që ndërlidhen me përmbushjen e këtyre veprimeve, po ashtu, ju kam dërguar letër ministrave me obligimet të cilat i kanë. Në përmbushjen e obligimeve ka ndikuar edhe mungesa e konstituimit të Parlamentit, pasi konsideroi se deri më tani një pjesë të madhe të këtyre ligjeve do të ishin miratuar. Ajo që ne mund të bëjmë tani është përshejtim i punës dhe se një pjesë e veprimeve nuk kërkojnë miratim në Parlament. Po tentojmë që deri në fund të qershorit obligimet nga ERA t'i kemi të përfunduara. Sa i përket projektimit të IPA-së tha pajtohem që të kemi koordinim sa më të mirë sepse ne i dimë më së miri nevojat tona, andaj edhe duhet të kemi pronësinë e këtij procesi. Sa i përket demarkacionit unë në të gjitha takimet që kam zhvilluar me përfaqësues të BE-së i kam njoftuar me të arriturat dhe zhvillimet e fundit në vend dhe në Qeverinë e re, si dhe me iniciativën e Kryeministrit për demarkacionin. Por, prapë është përsëritur se ratifikimi i marrëveshjes së kufirit është kusht dhe ka qenë kërkesë që të bëhet sa më shpejt për shkak të zgjedhjeve që do t'i kenë në BE. Sa i përket presionit për intensifikim të punëve tha kam qenë shumë e prerë që ata bartës të institucioneve të cilët nuk do t'i kryejnë detyrat do t'i përmendi me emra sepse duhet të kenë përgjegjësi më të madhe. Sa i përket zbatimit të MSA-së që ka një përqindje të vogël të zbatimit të saj, pra për 2 vjet vetëm 34% të veprimeve janë përmbushur, por tha nëse kemi parasysh që kemi një afat prej 10 viteve për implementim edhe kjo përqindje paraqet progres, por nuk duhet të jemi të kënaqur me këtë progres. Njoftoi se Qeveria ka filluar të hartoi një plan konkret për zbatimin e MSA-së, i cili plan do të shpie në aplikimit për statusin e vendit kandidat në fund të vitit 2018. Sa i përket aplikimit për statusin e shteti kandidat dua të bëjë të qartë se një shtet mund të aplikoj për shtet kandidat edhe pse nuk ka përmbushur qind për qind veprimet nga MSA-ë. Sa i përket mos zbatimit të vendimeve nga ana e zyrtarëve të lartë tha as unë nuk e shoh të kuptimtë dhe se kuptoi mos zbatimin e vendimeve, por besoj që Qeveria ka mekanizmat e vet me të cilët do të rregullojë edhe këtë problem. Sa i përket projektligjit për suspendimin e zyrtarëve të lartë të dyshuar për korrupsion tha është një koncept dokument ku pastaj dispozitat që do të dalin nga ky dokument do të inkorporohen

në Kodin Penal dhe të Procedurës penale, pra ka të bëjë vetëm me eliminimin e zbrazëtirave ligjore që kanë ekzistuar.

Milaim Zeka: Çështja e fondeve është çështje shumë e ndjeshme. Pyeti: a i keni njoftuar ndonjëherë përfaqësuesit e BE-së se keqpërdorimi me i madh i këtyre fondeve është bërë nga vetë zyrtarët e BE-së. Rekomandoi që kur të diskutohet për këtë çështje t'ju referohen gazetave evropiane, siç është Deutsche Caitung, e cila ka zbuluar skandale të mëdha për keqpërdorimin e këtyre fondeve nga ana e zyrtarëve të BE-së në Kosovë, ku janë keqpërdorur mbi 480 milionë euro nga burokratët e BE-së që janë të instaluar në Kosovë. Të flisni për skandalet brenda për brenda misionin të EULEX-it, ku korrupsioni ka qenë shumë i lartë në mesin e prokurorëve dhe gjykatësve të një pjese të misioni gjithashtu të flisni për skandalin e zyrtarit të OSCE-së Gerhard Fischer dhe zyrtari tjetër Jo Trutshler, zyrtar i lartë i cili është dënuar me katër vite burg nga gjykata gjermane për shkak të keqpërdorim të 5 milionë eurove të dedikuara për KEK-un, e që ka qenë drejtor i përgjithshëm i KEK-it. Këto i potencova me qëllim që ju në të gjitha takimet që zhvillonit t'ju potenconi se keqpërdorimi më i madh që i u është bërë fondeve të taksa paguesve evropianë, janë bërë kryesisht nga burokratët e BE-së të instaluar në Kosovë. Pyetja ime shkon për Kryeprokurorin, Aleksandër Lumezi, tani ka dalë skandali që ai është vënë në kreun e institucionit të akuzës, po në fakt ai vetë e ka provimin e jurispondencës komplet të falsifikuar, sa do të ndikojë kjo në avancimin e agjendës evropiane dhe a keni pasur pyetje lidhur me këtë çështje në takimet që i kishit në Bruksel.

Ilir Deda: tha se sa i përket aplikimit për statusin e vendit kandidat, tha nëse nuk mundemi me zbatuar, as ERA-në 100%, ne nuk kemi kredibilitet për me aplikuar për statusin kandidat, dhe nëse ne pretendojmë me aplikuar në fund vit të 2018 dhe në vitin 2019 mbajnë zgjedhjet në institucionet e BE-së, ne nuk do të kemi sukses. Po ashtu kërkoi nga Ministria që t'i njoftojë anëtarët e qeverisë se BE-ja ka një dinamikë të veten ku dinamika e Qeverisë tonë nuk përputhet fare me dinamikën e BE-së. Kërkoi prapë që të dihet se pa demarkacion nuk ka liberalizim të vizave. Çështja e demarkacionit tha duhet të jetë shumë e qartë si për kabinetit qeveritar, si për deputetët, si për qytetarët se është kusht pa të cilin s'mund të marrim liberalizimin e vizave. Ne në javën e ardhshme do ta kemi për raportim në Komision z.Bulliqajn dhe do të shohim me fakte se çka janë të gjeturat e këtij Komisioni të ri shtetëror.

Armend Zemaj: tha se po më vjen mirë që ju jeni shumë transparent në këtë drejtim, e jo të mbuloni gjendjen reale me dëshira personale. Sa i përket hartimit të koncept dokumenteve për largimin e zyrtarëve të korruptuar, ashtu siç ju po planifikoni është procedurë shumë e gjatë andaj rekomandoi që të bashkëpunohet me institucionin e prokurorisë në mënyrë që të kërkohet nga ky institucion të dhënat për ngritje të aktakuzave për të gjithë zyrtarët të cilët punojnë në institucionet e Kosovës, e këtë pastaj ta adresoni në ministritë e linjës dhe nëse ekziston vullneti do të merren masa para se të vjen te ndryshime plotësimi i kodit të procedurës penale dhe hartimit të koncept dokumenteve. Kjo tha do të ndikojë edhe në krijimin e një perceptioni më të mirë te qytetarët tanë.

Kryetarja: tha se Komisioni për Integritet Evropian ka një dinamikë të shtuar të punës dhe jemi të interesuar që secilin resor qeveritar ta ftojë në Komision me qëllim të mbikëqyrjes së përmbushjes së veprimeve të ERA-së. Ju tha e përmendet ministre që do t'i përmendi me emër ata të cilët nuk do t'i përmbushin obligimet e tyre, por ekziston Këshilli për Integritet Evropian i udhëhequr nga Kryeministri ku duhet të ekzistoj

vullneti politik që jo vetëm të përmenden me emra, por edhe të merren masa, sepse edhe ne do t'i ftojme në komision për të parë pse ka zvarritje dhe cilat janë problemet për zvarritje e përmbushjes së këtyre agjendave.

Dhurata Hoxha, ministre: tha se edhe BE-ja ka pasur skandale të shumta dhe këto informata janë përdorur dhe potencuar dhe premtoi qëçdo fakt dhe raport i ri do të përdoret. Sa i përket organizatave ndërkombëtare nuk është se kemi ndonjë mekanizëm për të bërë ndonjë ndryshim, ajo që ne mund të bëjmë është të bëjmë presion e asgjë më shumë. Neve na mbetet që të luftojmë korrupsionin dhe krimin e organizuar në oborrin tonë. Sa i përket çështjes së Kryeprokurorit kam dëgjuar që ministri i Drejtësisë ka kërkuar që të bëhet një hulumtim lidhur me këtë çështje, andaj nuk dua të spekuloj asgjë, por që mund t'ju njoftoj se lidhur me këtë çështje nuk më ka pyetur asnjë përfaqësues i BE-së. Sa i përket aplikimit për statusin e vendit kandidat tha ne kemi marrë këshillë nga përfaqësuesit e BE-së që ky proces të shkoj në koordinim të plot më shtetet anëtarë të BE-së, pra, nuk do të bëjmë aplikimin në mënyrë të një anshme dhe vetëm pasi të krijojmë një kredibilitet se mund të bëjmë implementim të kënaqshëm të ERA-së. Sa i përket demarkacionit unë po besoj se shumë shpejt edhe Qeveria do të marrë një raport me rekomandime nga Komisioni i ngarkuar për këtë çështje dhe se shumë shpejt do ta procedojë për ratifikim në Parlament. Sa i përket koncept dokumentit për pezullimin e zyrtarëve e vërtetë që kjo merr shumë kohë, por besoj që Qeveria do të gjejë modalitet për përmbushjen e këtyre kriterëve. Në fund falënderoi anëtarët e Komisionit për përkrahjen dhe angazhimin në mbikëqyrjen e përmbushjes së kësaj agjende, sepse integrimi evropian është proces që patjetër duhet ta implementojmë sepse nuk ka zgjidhje tjetër përveç anëtarësimit në BE.

Kryetarja: falënderoi ministren për gatishmërinë për raportim dhe bashkëpunim dhe kërkoj që të organizohet edhe një takim i Komisionit për të diskutuar për fondet e BE-së, pasi që edhe në seancë janë ngritur shqetësime rreth mënyrës së shfrytëzimit të këtyre fondeve.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra